

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	"Muzg në kopshtin e qershive" çeli sezonin e ri në Teatrin Kombëtar
ADRESA	https://www.gazetatema.net/kulture/muzg-ne-kopshtin-e-qershive-celi-sezonin-e-ri-ne-teatrin-kombetar-i588246
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	25 shtator 2026, 07:41:47 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	25 shtator 2026, 07:36:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	7362e26bb37885d6dd0b4f36921e94b3e9ec23ddf5bf78bc6dbb3959c4c4cb6a
TEKSTI	5c305ba3326440b418013086fa4099c648a2174e8274236d8d237d8a2c1d7234
PAMJA	cb9e1e8c228b54f22e7f1580224b9e030497126fcf099e2c65ab29a8e49559ac

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	57696c0a92156a2a684e299774919f3616c987da64f9af1900a9ad946679bc8d
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	03bdce4b1a721a6f1a89a4ef485ddb946ec31f15b1790ea3cb05a93e1803ce0e
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahajo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/57696c0a92156a2a684e299774919f3616c987da64f9af1900a9ad946679bc8d>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

 [English](#)

Built and Monetized by 

[Kontakt](#)



 [English](#)



ie [Serbet e Kosoves mes listes se Vuçiqit dhe asaj studentore](#)[Angelina Jolie shet rezidencen historike ne Los Angeles per 24.75 milione dollare](#)["Muzg ne kopshtin e qershive"](#)
fundit

“Muzg në kopshtin e qershive” çeli sezonin e ri në Teatrin Kombëtar



25 Shtator 2026, 09:36Kulturë TEMA



“Muzg në kopshtin e qershive” çeli sezonin e ri në Teatrin Kombëtar...

Bazuar në veprat e shkrimtarit rus Anton Chekhov dhe dramaturgut amerikan Lillian Hellman, regjisorja Driada Dervishi ngjith në skenë një vepër aktuale, që gati gati duket si kronikë e zhvillimeve të ditës...

“Gjërat që ne po përjetojmë sot këtu, një pjesë e madhe i madhe i kanë përjetuar apo i përjetojnë akoma. Por, njerëzit, do i kthehen gjenezës... lidhjes me tokën”, tha Adem Karaga, aktor.

Një projekt për ndërtimin e një resorti në një kopsht me qershi përplas anëtarët e një familjeje, që janë produkt i një incesti. Intriga njëra pas tjetrës që rihapin konflikte të vjetra...

Ndërsa të rriturit ndajnë tokën dhe llogarisin fitimet, vajza e shtëpisë është e para që pyet çfarë do të mbetet pasi të priten të gjitha pemët.

“Nuk është vetëm roli i nënës kundrejt vajzës, por është e gjithë çfarë ndodh në familje, të gjitha dramat sociale që ndodhin sot. Të gjitha problemet, fëmija i shtëpisë, që e luaj unë, i përjeton shumë”, u shpreh Alesia Xhemalaj, aktore.

“Në këtë gjendje jemi sepse familja është shpërbërë. Këta janë njerëz që nuk kanë skrupuj, edhe fëmijën e mësojnë gangster dhe hajdut. Kjo shfaqje ka mesazhe shumë të forta dhe është ajo që teatri duhet të bëjë, është një pasqyrë që ne i vëmë publikut, që shoqëria të kuptojë veten dhe për përjetojë katarsis”, deklaroi Neritan Liçaj, aktor.

Një histori për ndryshimin, kujtesën, humbjen dhe fillimet e reja... me mesazhe të forta që cekin jetën sociale dhe politike të shoqërisë...

“Kujtimet nuk janë për shitje” na tregon se në këtë tranzicion që po kalon shoqëria jone, ne duhet të shkojmë duke mbartur ato kujtimet e vegjëlisë. Mund të ketë zhvillim, por duke ruajtur atë që me shekuj na erdhi deri më sot”, tha Laert Vasili, aktor.

Për “Muzg në kopshtin e qershive” janë shitur të gjitha biletat për muajin shtator, ndërkohë që do të vijojë për publikun edhe përgjatë tetorit. A.K./Tema



Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[Në Muzeun Historik të Shkodrës u zhvillua aktiviteti “Art-Land – Duke Festuar Biodiversitetin e Shkodrës nëpërmjet artit”](#)

17:18 Kulturë

Tedi Papavrami bëhet pjesë e TIFF

16:17 Kulturë

Amfiteatri i Durrës pret shfaqjen bullgare "The Little Dog Laughed"

15:16 Kulturë

Joni Shanaj: Problemet e filmit shqiptar nuk vijnë për shkak të ligjit

13:12 Kulturë / 1 koment

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.